



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:286348

Datë: 29.02.2024

Numri i dokumentit: 05396925

C.nr.831/2022

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, gjyqtari Besmir Juniku, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.G nga fshati Gërqinë, Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson Av. D.M nga Prizreni, kundër të paditurës S, me seli në Prishtinë, me bazë juridike – kompensim i dëmit, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë **29.02.2024** merr këtë:

A K T V E N D I M

Padia e paditësit A.G nga fshati Gërqinë, Komuna e Prizrenit, në lidhje me këtë çështje juridike **KONSIDEROHET E TËRHEQUR**.

A r s y e t i m

Paditësi A.G nga fshati Gërqinë, Komuna e Prizrenit, përmes të autorizuarit të tij Av.D.M, në këtë gjykatë kanë parashtruar padi kundër të paditurës S, me seli në Prishtinë, me bazë juridike – kompensim i dëmit.

Gjykata me Aktvendimin C.nr.831/2022 të datës 22.03.2023 e ka ftuar paditësin që në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh ta paguaj taksën gjyqësore për padinë e parashtruar, me vërejtje se në rast se të njëjtën nuk e paguan në afatin e lartcekur, do të konsiderohet se ka bërë tërheqjen e padisë.

Në shkresat e lëndës ekziston prova – fletëkthesa se i autorizuari i paditësit me datë 04.04.2023 e ka pranuar aktvendimin e lartcekur, ndërsa nuk e ka bërë pagesën e taksës gjyqësore të kërkuar për padinë e parashtruar.

Sipas nenit 253 par. 5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore Nr. 03/L-006 (LPK) është paraparë se: *“253.5 Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.”*

Duke marr parasysh faktin se as pas aktvendimit të dërguar nga gjykata, paditësi nuk e ka bërë pagesën e taksës gjyqësore për padinë e parashtruar, brenda afatit të përcaktuar, ndërsa nuk ekzistojnë kushtet për lirimin e tij nga pagesa e së njëjtës, gjykata ka vendosur si në

dispozitiv të këtij aktvendimi, konform nenit 253 par. 5, lidhur me nenin 387 par. 1 pika c) të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.831/2022, datë 29.02.2024

Gj y q t a r i
Besmir Juniku

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.